



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**  
**DREJTORIA PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT**  
**TË BURIMEVE NATYRORE**  
**DREJTORIA MINERARE DHE INDUSTRIALE**

---

**UDHËZIM**

Nr. 418, datë 03.10.2011

**PËR**  
**MËNYRËN E VLERËSIMIT TË GARANCIVE FINANCIARE TË LEJEVE**  
**MINERARE.**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 31, pika 1, 2 dhe 3, nenit 43 pika 2/e, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", dhe pikave 1, 3, 15 dhe 22 të VKM nr. 440, datë 16.06.2011 "Për miratimin e formës të kushteve të rikthimit dhe të mënyrës së llogaritjes, së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin e investimit":

**UDHËZOJ**

1. Institucionet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për lejet e kërkim-zbulimit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit bëjnë vlerësimin e përlllogaritjeve të vlerave të garancive financiare të lejeve minerare dhe e dërgojnë atë për miratim tek ministri brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë" dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
2. Përlllogaritjet e garancive financiare për çdo leje minerare realizohen nga subjektet që zotërojnë një leje minerare ose janë pjesë e dokumentacionit të përfundimit të një leje minerare në përputhje me kërkesat e:
  - a) Legjislacionit për mjedisin;
  - b) Ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë";
  - c) VKM nr. 440, datë 16.06.2011 "Për miratimin e formës të kushteve të rikthimit dhe të mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe për realizimin e investimit";
  - d) Urdhrit nr. 304, datë 13.04.2011 "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare";


- e) Urdhrit nr. 383, datë 20.05.2011 “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të veprimtarive për mbylljen e një veprimtarie minerare”;
  - f) Urdhrit nr. 388, datë 20.05.2011 “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të monitorimit post-minerar”;
  - g) Urdhrit nr. 414, datë 03.06.2011 “ Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të menaxhimit dhe informacioneve që mbahen nga zotëruesi i lejes minerare për punimet e kryera, depozitimin, trajtimin e mbetjeve minerare dhe analizimin e tyre”.
  - h) Urdhrit nr. 302, datë 12.04.2011 “ Për miratimin e parimeve bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare dhe të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare”.
3. Garancia financiare për realizimin e investimit është një garanci financiare që paguhet çdo vit në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së investimit të programuar për çdo vit, në cash flow e paraqitur nga subjekti në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare. Vlera e përgjithshme e investimit nuk mund të jetë më e vogël se vlera minimale e miratuar në aneksin 2, të VKM nr.364, datë 04.05.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”. Vlera monetare vjetore vlerësohet nga institucioni i AKBN dhe është e barabartë për vitin e parë me 10 % të vlerës monetare të investimit vjetor, që përcaktohet në projektin e miratuar të zhvillimit të veprimtarisë minerare për çdo leje minerare shfrytëzimi ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi (sipas Cash Flow) dhe për vitet në vazhdim është e barabartë me 10% të vlerës së investimit të miratuar në programin vjetor të zhvillimit të veprimtarisë minerare. Një shembull përlllogaritje i vlerës vjetore të garancisë financiare për realizimin e investimit jepet në aneksin 1, të këtij udhëzimi.
  4. Garancia financiare për realizimin e programit minimal të punës është një garanci financiare që paguhet çdo vit në datën efektive të marrjes së lejes dhe vlera vjetore përcaktohet në bazë të vlerës së programit minimal të punës për çdo vit, për dy vitet e para të lejes së kërkim-zbulimit, në bazë të programit minimal të punës të paraqitur nga subjekti në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare. Vlera minimale e përgjithshme e programit minimal të punës nuk mund të jetë më e vogël se vlera minimale e investimit të miratuar në aneksin 1, të VKM nr.364, datë 04.05.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”. Vlera minimale e përgjithshme e programit minimal të punës vlerësohet nga institucioni i SHGJSH dhe është e barabartë me produktin e vlerës për km<sup>2</sup> të zonës së lejuar minerare, të shumëzuar me vlerën për km<sup>2</sup> të vlerës minimale të investimit për aktivitetin e kërkimit të mineraleve gjatë dy viteve të para të lejes së kërkim zbulimit sipas grupeve të mineraleve. Një shembull përlllogaritje i vlerës vjetore të garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës jepet në aneksin 2, të këtij udhëzimi.
  5. Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit vlerësohet nga institucioni i SHGJSH. Vlera e përgjithshme e garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit përlllogaritet në bazë të aktiviteteve të programuara në projektin e veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit. Preventivat tip për vlerësimin e vlerës monetare të planit të rehabilitimit për lejet e kërkim-zbulimit jepen në aneksin 3 të këtij udhëzimi dhe bazohen në proceset që parashikohen të realizohen në veprimtarinë e kërkim-zbulimit. Një shembull përlllogaritje i vlerës vjetore të garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës jepet në aneksin 3, të këtij udhëzimi.

6. Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit vlerësohet nga institucioni i AKBN. Vlera e përgjithshme e garancisë financiare për realizimin e planit për rehabilitimin e mjedisit përlllogaritet në bazë të aktiviteteve të programuara në projektin e veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit-shfrytëzimit. Preventivat tip për vlerësimin e vlerës monetare të planit të rehabilitimit për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit jepen në aneksin 4, të këtij udhëzimi dhe bazohen në mënyrën e shfrytëzimit dhe grupet e mineraleve. Shembuj përlllogaritje të vlerës vjetore të garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës jepen në aneksin 4, të këtij udhëzimi
7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Institucionet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për lejet e kërkim-zbulimit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe Drejtoria përgjegjëse në METE që mbulon veprimtarinë minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO





## ANEKSI 2

### Mënyra e vlerësimit të garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit.

Për një zonë të caktuar kërkim zbulimi minimalisht gjatë dy viteve të para subjekti duhet të bëjë kërkimin e zonave brenda zonës së lejuar në të cilën ai do të vazhdojë zbulimin. Kërkimi i zonës së lejuar do të kryhet për të gjithë sipërfaqen e zonës së lejuar. Në tabelën e mëposhtme jepet mënyra e llogaritjes së Vlerës minimale e investimit dhe vlerës minimale të garancisë për programin minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit.

| Sipërfaqja e zonës së lejuar | Grupi i mineraleve                         | Vlera minimale e investimit dhe vlera minimale e garancisë për programin minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit |   | Vlera minimale totale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës |
|------------------------------|--|---|---|--|
|                              |  | Vlera minimale e investimit për programin minimal të punës EURO/km <sup>2</sup> sipas VKM nr.364, datë 04.05.2011     | Vlera minimale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës sipas grupeve të mineraleve |  |
| A- km <sup>2</sup>           | Metalore, jometallore, qymyret dhe bitumet | 20000 EURO/km <sup>2</sup>  | 15 000 EURO/ km <sup>2</sup>  | A x 15 000 EURO  |
| B- km <sup>2</sup>           | Mineraleve ndërtimore                      | 10000 EURO/ km <sup>2</sup>   | 8 000 EURO/ km <sup>2</sup>   | B x 8 000 EURO   |
| C- km <sup>2</sup>           | Mineraleve radioaktive                     | 30000 EURO/ km <sup>2</sup>   | 20 000 EURO/ km <sup>2</sup>  | C x 20 000 EURO  |

Kjo vlerë mund të shpërmdahet nga subjekti për të dy vitet e para të kërkim zbulimit, për grupin e mineraleve metalore, jometallore, qymyret dhe bitumet dhe grupin e mineraleve radioaktive ose mund të vendoset në një vit kjo varet nga projekti i paraqitur nga subjekti për veprimtarinë minerare të kërkim zbulimit. Për mineralet ndërtimore kjo vlerë do të jetë për një vit sepse dhe afati i saj është një vjeçare.

Vlera monetare për realizimin e programit minimal do të përllogaritet mbi bazën e punimeve minimale të kërkimit të projektuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim zbulimit me anë, të të cilit do të përcaktohen zonat ku mendohet të realizohet puna e mëtejshme për zbulimin e trupave minerare, por nuk mund të jetë dhe më i vogël se vlera minimale totale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës e përllogaritur në tabelë.

Ndërsa vlera minimale e investimit për një km<sup>2</sup> për veprimtari zbulimi do të jetë ajo e përcaktuar në VKM nr.364, datë 04.05.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës se lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”, ndërsa vlera e sipërfaqes mund të ndryshojë nga vlera e sipërfaqes së zonës së lejuar të kërkim zbulimit sipas rezultateve të kërkimit të vitit të parë ose të dytë.

**Shembull përlllogaritje i garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit**

| Sipërfaqja e zonës së lejuar | Grupi i mineraleve                        | Vlera minimale e investimit dhe vlera minimale e garancisë për programin minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit |   | Vlera minimale totale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës | Vlera minimale e programit minimal të punës për vitin e parë (kur shpërndarja behet 50% për çdo vit) | Vlera minimale e programit minimal të punës për vitin e dytë |
|------------------------------|---|---|---|--|--|--|
|                              |   | Vlera minimale e investimit për programin minimal të punës EURO/km <sup>2</sup> sipas VKM nr.364, datë 04.05.2011     | Vlera minimale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës sipas grupeve të mineraleve |  |  |  |
| 10- km <sup>2</sup>          | Metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet | 20000 EURO/ km <sup>2</sup>   | 15 000 EURO/ km <sup>2</sup>  | 10 x 15000 =<br>150 000 EURO   | 75 000 EURO  | 75 000 EURO  |
| 10- km <sup>2</sup>          | Mineraleve ndërtimore                     | 10000 EURO/ km <sup>2</sup>   | 8 000 EURO/ km <sup>2</sup>   | 10 x 8000 =<br>80 000 EURO   | 80 000 EURO  | -----  |
| 10- km <sup>2</sup>          | Mineraleve radioaktive                    | 30000 EURO/ km <sup>2</sup>   | 20 000 EURO/ km <sup>2</sup>  | 10 x 20000 =<br>200 000 EURO   | 100 000 EURO   | 100 000 EURO   |

Vlera e përgjithshme për programin minimal të punës mund të ndahet për dy vitet e para ose mund të vendoset e gjitha që në vitin e parë për mineralet metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, si dhe mineralet radioaktive, ndërsa për mineralet ndërtimore kjo vlerë është për një vit, pasi dhe leja e kërkim-zbulimit për këto minerale është për një vit. Përqindja e shpërndarjes në të dy vitet përcaktohet nga vetë subjekti në projektin e tij të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit që miratohet nga Këshilli Teknik i institucionit të SHGJSH.

**ANEKSI 3**

**Mënyra e vlerësimit të garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit për lejet e kërkim-zbulimit.**

| <b>I</b>   |  |   |                        |                        |                      |
|--|--|---|------------------------|------------------------|----------------------|
| <b>Plani i mbylljes së punimeve të kërkim zbulimit</b> |  |   |                        |                        |                      |
| <b>Nr.</b>   | <b>Operacioni</b>  | <b>Njësia</b>                                     | <b>Çmimi për njësi</b> | <b>Vëllimi i punës</b> | <b>Vlera në lekë</b> |
| <b>a</b>   | Mbyllje e hyrjes së galerive me mur.   | Nr. galerish                                      | 25 000                 | A                      | A x 25000            |
| <b>b</b>   | Mbyllje e puseve minerare sipërfaqësore me mbushje të plotë.   | m <sup>3</sup>                                    | 100                    | B                      | B x 100              |
| <b>c</b>   | Mbyllje e oxhaqeve, remonteve nga nëntoka me dalje në sipërfaqe me mbushje të plotë.                             | m <sup>3</sup>                                    | 100                    | C                      | C x 100              |
| <b>d</b>   | Mbyllje e grykave të puseve të shpimit (Me saldim në tube rrethimi)  | Nr. shpimesh                                      | 1 000                  | D                      | D x 1 000            |
| <b>Shuma I</b>   |  | <b>A x 25 000 + B x 100 + C x 100 + D x 1 000</b> |                        |                        |                      |
| <b>II</b>  |  |   |                        |                        |                      |
| <b>Plani i menaxhimit të mbetjeve</b>                  |  |   |                        |                        |                      |
| <b>Nr.</b>   | <b>Operacioni</b>  | <b>Njësia</b>                                     | <b>Çmimi për njësi</b> | <b>Vëllimi i punës</b> | <b>Vlera në lekë</b> |
| <b>a</b>   | Çmontim, transport i instalimeve të trajtimit të punëtoreve në sektor, barangave në frontet e punës.             | Nr. objektsh                                      | 10 000                 | A1                     | A1 X 10000           |
| <b>b</b>   | Çmontim, transporti i makinerive dhe pajisjeve teknologjike të punës si sonda shpimi, kompresorë, pompa uji etj. | Nr. makinerish                                    | 5 000                  | B1                     | B1 X 5000            |

|                            |  |   |                         |                        |                      |
|----------------------------|--|---|-------------------------|------------------------|----------------------|
| <b>c</b>                   | Çmontim, transporti i linjave teknologjike si linjë e energjisë elektrike, linjë e furnizimit me ujë, linjë të furnizimit me ajër etj. | ml  | 50                      | <b>C1</b>              | <b>C1 X 50</b>       |
| <b>d</b>                   | Transport i kampjonaturës së shpimit, si dhe çdo produkti tjetër nga aktiviteti mineral për sistemim jashtë zonës minerare.            | ton   | 1 000                   | <b>D1</b>              | <b>D1 X 1 000</b>    |
| <b>Shuma II</b>            |  | <b>A1 x 10 000 + B1 x 5 000 + C1 x 50 + D1 x 1 000</b>                |                         |                        |                      |
| <b>III</b>                 | <b>Plani i rehabilitimit përfundimtar të mjedisit</b>  |   |                         |                        |                      |
| <b>Nr.</b>                 | <b>Operacioni</b>  | <b>Njësia</b>   | <b>Çmimi për njësi</b>  | <b>Vëllimi i punës</b> | <b>Vlera në lekë</b> |
| <b>a</b>                   | Tarracim, sistemim, rehabilitim (mbushje me dhe) i stoqeve të sterilit të galerive të kërkimi zbulimit                                 | m <sup>3</sup>  | 100 lekë/m <sup>3</sup> | A2                     | A2 X 100             |
| <b>b</b>                   | Tarracim, sistemim, rehabilitim (mbushje me dhe) i stoqeve të sterilit nga hapja e shesheve të shpimit                                 | m <sup>3</sup>  | 75 lekë/m <sup>3</sup>  | B2                     | B2 X 75              |
| <b>c</b>                   | Tarracim, sistemim, rehabilitim (mbushje me dhe) i stoqeve të sterilit nga hapja e karrierve të kërkim-zbulimit                        | m <sup>3</sup>  | 75 lekë/m <sup>3</sup>  | C2                     | C2 X 75              |
| <b>d</b>                   | Sistemim-rehabilitim i sterileve nga hapja e punimeve të kërkimit si kanale, etj.  | m <sup>3</sup>  | 50 lekë/m <sup>3</sup>  | D2                     | D2 X 50              |
| <b>e</b>                   | Mbjellje pemësh  | copë  | 300 lekë/copë           | E2                     | E2 X 300             |
| <b>f</b>                   | Sistemim i ujërave nëntokësore   | raste   | 3000                    | F2                     | F2 X 3 000           |
| <b>Shuma III</b>           |  | <b>A2 x 100 + B2 x 75 + C2 x 75 + D2 x 50 + E2 x 300 + F2 x 3 000</b> |                         |                        |                      |
| <b>Shuma I+II+III</b>      |  | <b>Shuma I + Shuma II + Shuma III</b>                                 |                         |                        |                      |
| Shpenzime suplementare, 5% |  | 0.05 x (Shuma I + Shuma II + Shuma III)                               |                         |                        |                      |



|               |   |
|---------------|---|
| <b>TOTALI</b> | <b>(Shuma I + Shuma II + Shuma III) + {0.05 x (Shuma I + Shuma II + Shuma III)}</b> |
|---------------|---|

Kjo vlerë totale e planit të rehabilitimit duhet të shpërndahet për numrin e viteve të afatit fillestar të lejes së kërkim zbulimit. pra vlera vjetore do të jetë e barabartë me vlerën e përgjithshme pjesëtuar me numrin e viteve të periudhës fillestare të lejes së kërkim zbulimit.

**Shembull përlogaritje i garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit për lejet e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet.**

| <b>I</b>       | <b>Plani i mbylljes se punimeve të kërkim zbulimit</b>   |                |                        |                        |                      |
|----------------|--|----------------|------------------------|------------------------|----------------------|
| <b>Nr.</b>     | <b>Operacioni</b>  | <b>Njësia</b>  | <b>Çmimi për njësi</b> | <b>Vëllimi i punës</b> | <b>Vlera në lekë</b> |
| <b>a</b>       | Mbyllje e hyrjes së galerive me mur.   | Nr. galerish   | 25 000                 | 2                      | 50000                |
| <b>b</b>       | Mbyllje e puseve minerare sipërfaqësore me mbushje të plotë.   | m <sup>3</sup> | 100                    | 100                    | 10000                |
| <b>c</b>       | Mbyllje e oxhaqeve, remonteve nga nëntoka me dalje në sipërfaqe me mbushje të plotë.                 | m <sup>3</sup> | 100                    | 200                    | 20000                |
| <b>d</b>       | Mbyllje e grykave të puseve të shpimit (Me saldëm në tube rrethimi)                                  | Nr. shpimesh   | 1 000                  | 5                      | 5000                 |
| <b>Shuma I</b> |  | <b>85 000</b>  |                        |                        |                      |
| <b>II</b>      | <b>Plani i menaxhimit të mbetjeve</b>  |                |                        |                        |                      |
| <b>Nr.</b>     | <b>Operacioni</b>  | <b>Njësia</b>  | <b>Çmimi për njësi</b> | <b>Vëllimi i punës</b> | <b>Vlera në lekë</b> |
| <b>a</b>       | Çmontim, transport i instalimeve të trajtimit të punëtoreve në sektor, barangave në frontet e punës. | Nr. objektsh   | 10 000                 | 2                      | 20000                |
|                | Çmontim, transporti i makinerive dhe pajisjeve   | Nr.            | 5 000                  | 3                      | 15000                |

|                            |  |                |                         |                        |                      |
|----------------------------|--|----------------|-------------------------|------------------------|----------------------|
| <b>b</b>                   | teknologjike të punës si sonda shpimi, kompresorë, pompa uji etj.  | makinerish     |                         |                        |                      |
| <b>c</b>                   | Çmontim, transporti i linjave teknologjike si linjë e energjisë elektrike, linjë e furnizimit me ujë, linjë të furnizimit me ajër etj. | ml             | 50                      | 200                    | <b>10000</b>         |
| <b>d</b>                   | Transport i kampjonaturës së shpimit, si dhe çdo produkti tjetër nga aktivitetit minerar për sistemim jashtë zonës minerare.           | ton            | 1 000                   | 5                      | <b>5000</b>          |
| <b>Shuma II</b>            |  | <b>50 000</b>  |                         |                        |                      |
| <b>III</b>                 | <b>Plani i rehabilitimit përfundimtar të mjedisit</b>  |                |                         |                        |                      |
| <b>Nr.</b>                 | <b>Operacioni</b>  | <b>Njësia</b>  | <b>Çmimi për njësi</b>  | <b>Vëllimi i punës</b> | <b>Vlera në lekë</b> |
| <b>a</b>                   | Tarracim, sistemim, rehabilitim (mbushje me dhe) i stoqeve të sterilit të galerive të kërkimi zbulimit                                 | m <sup>3</sup> | 100 lekë/m <sup>3</sup> | 150                    | 15000                |
| <b>b</b>                   | Tarracim, sistemim, rehabilitim (mbushje me dhe) i stoqeve të sterilit nga hapja e shesheve të shpimit                                 | m <sup>3</sup> | 75 lekë/m <sup>3</sup>  | 70                     | 5250                 |
| <b>c</b>                   | Tarracim, sistemim, rehabilitim (mbushje me dhe) i stoqeve të sterilit nga hapja e karrierve të kërkim-zbulimit                        | m <sup>3</sup> | 75 lekë/m <sup>3</sup>  | 50                     | 3750                 |
| <b>d</b>                   | Sistemim-rehabilitim i sterileve nga hapja e punimeve të kërkimit si kanale, etj.  | m <sup>3</sup> | 50 lekë/m <sup>3</sup>  | 50                     | 2500                 |
| <b>e</b>                   | Mbjellje pemësh  | copë           | 300 lekë/copë           | 20                     | 6000                 |
| <b>f</b>                   | Sistemim i ujërave nëntokësore   | raste          | 3000                    | 1                      | 3000                 |
| <b>Shuma III</b>           |  | <b>35 500</b>  |                         |                        |                      |
| <b>Shuma I+II+III</b>      |  | <b>170 500</b> |                         |                        |                      |
| Shpenzime suplementare, 5% |  | 8 525          |                         |                        |                      |

|                      |                |
|----------------------|----------------|
| <b>TOTALI (lekë)</b> | <b>179 025</b> |
|----------------------|----------------|

(Shënim: vlerat e volumeve në këtë shembull, janë thjesht vlera për llogaritje dhe nuk mund të shërbejnë si vlera indikativë për përlogaritjen e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit për lejet e kërkim zbulimit, vlerat e volumeve duhet të bazohen në vlerat reale të dhëna në projektet e miratuara të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit)

Pra vlera vjetore e garancisë për realizimin e planit të rehabilitimit për këtë rast, duke ditur që periudha fillestare e lejes së kërkim-zbulimit për këtë grup mineralesh është 3 vjet do të jetë e barabartë me  $179\ 025/3 = 59675$  lekë/vit.

#### ANEKSI 4

**Mënyra e vlerësimit të garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim shfrytëzimit.**

Për rastin e lejeve të shfrytëzimit, dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit preventivat tip për përcaktimin e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit janë ndarë në dy grupe sipas mënyrës së shfrytëzimit me nëntokë dhe sipërfaqe:

1. Për shfrytëzim me nëntokë
  - a) Preventiv tip i planit të rehabilitimit të një miniere nëntokësore të hapur me punime horizontale e të pjerrët.
  - b) Preventiv tip i planit të rehabilitimit të një miniere nëntokësore të hapur punime vertikale.
2. Për shfrytëzim sipërfaqësor
  - a) Preventiv tip i rehabilitimit të 1 ha karriere, për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret e bitumet, për grupin e mineraleve të çmuar dhe gjysëm të çmuar, për grupin e mineraleve radioaktive.
  - b) Preventiv tip i planit të rehabilitimit të 1 ha karriere, Grupi mineraleve ndërtimore
  - c) Preventiv tip për planin e rehabilitimit të 1 ha karriere, argjile (Grupi mineraleve ndërtimore)

| <b>Preventiv tip i planit të rehabilitimit të një miniere nëntokësore të hapur me punime horizontale e të pjerrët</b> |                          |                                   |                                 |  |                                     |                                      |                                     |
|---|--------------------------|-----------------------------------|---------------------------------|--|-------------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>I</b>  |                          |                                   |                                 |  |                                     |                                      |                                     |
| <b>Plani i mbylljes e minierës</b>  |                          |                                   |                                 |  |                                     |                                      |                                     |
| <b>Nr.</b>  | <b>Emërtimi</b>          | <b>Seksioni<br/>m<sup>2</sup></b> | <b>Trashësia e<br/>murit, m</b> | <b>Volumi I murit,<br/>m<sup>3</sup></b> | <b>norma,<br/>Orë/m<sup>3</sup></b> | <b>Koha<br/>e<br/>punës,<br/>Orë</b> | <b>Vlera në lekë</b>                |
| a   | Mur betoni               | 5.2                               | 0.6                             | 3.43                                     | 3.5                                 | 12.01                                |                                     |
| b   | Operacione ndihmëse      | 5.2                               |                                 |  |                                     | 5.41                                 |                                     |
|   | Shuma a+b                | 5.2                               |                                 |  |                                     | 17.42                                |                                     |
|   |                          | <b>Orë pune</b>                   | <b>Nr.<br/>punëtorëve</b>       | <b>Orë pune<br/>gjithsej</b>             | <b>lekë/Orë pune</b>                |                                      | <b>Shpenzime<br/>gjithsej, lekë</b> |
| c   | Shpenz. për fuqi puntore | 17.42                             | 4                               | 69.67                                    | 280                                 |                                      | 19507                               |

|           | Shpenz. për materiale                            | Seksioni,<br>m <sup>2</sup> | Volumi I<br>murrit, m <sup>3</sup> | Normativa,<br>kg/m <sup>3</sup>                | Sasia , kv             | çmimi,<br>lekë/kv             | Vlera        |
|-----------|--|-----------------------------|------------------------------------|--|------------------------|-------------------------------|--------------|
